



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE  
D E K A N I

Nr. 85 Prot.

Durrës, më 06.02. 2024

**LËNDA:** Thirrja dhe kriteret e pranimit për programin e përbashkët të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "E Drejtë Publike", për vitin akademik 2023-2024

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**Prof.Dr. Kseanela SOTIROFSKI**

*E nderuar Znj.Rektore,*

Bazuar ne ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" në VKM-në nr.112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademike "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", në Urdhrin nr.601, datë 19.10.2023 për 'Hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të tretë "Doktoraturë" në "E Drejtë Publike" në Universitetin 'Aleksandër Moisiu' Durrës dhe në Universitetin "Tor Vergata" Romë, Itali", lutemi gjeni bashkëlidhur 'Thirrjen për aplikim për regjistrim në programin e Doktoraturës për vitin 2023-2024, pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, Universiteti 'Aleksandër Moisiu' Durrës'.

*Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,*

  
**DEKAN**  
**Prof.As.Dr. Andon KUME**  




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR REGJISTRIM  
NË PROGRAMIN E DOKTORATËS PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024,  
PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE,  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS**

Dekanati i Fakultetit të Shkencave Politike Juridike vendosi hapjen e Aplikimeve për Programin e Doktoratës në "E DREJTË PUBLIKE" për vitin akademik 2023-2024.

**KALENDARI I THIRRJES**

Afati i aplikimeve	08.02.2024 – 11.03.2024
Shqyrtimi i Dosjeve	11.03.2024 – 22.03.2024
Shpallja e listës paraprake	26.03.2024
Ankimimi	26.03.2024 – 29.03.2024
Shqyrtimi i ankimimeve	01.04.2024 – 03.04.2024
Shpallja e listës përfundimtare	04.04.2024

*Shënim:* Dorëzimi i dosjes së aplikimit me dokumentacionin e duhur, bëhet me rrugë postare në adresën: Universiteti "Aleksandër Moisiu", Lagja 1, Rruga e Currilave, Durrës, 2001, Shqipëri

*A. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në Programin e Doktoratës në E Drejtë Publike në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës*

Kriteret për pranimin në programin e studimit Doktoratë e dyfishtë në E Drejtë Publike:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta Bachelor dhe/ose Master i Shkencave ose ekuivalentin e tyre në profilin Drejtësi, Shkenca Politike, Administrim Publik, Histori dhe fusha të tjera të përafërta.
2. Të ketë rezultate të larta në secilin nga studimet e ciklit të parë dhe të dytë.
3. Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur ose e konvertuar nga MAS.
4. Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzim nr.10, datë 16.6.2023 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015, "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", i ndyshuar. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Diploma e fituar në një program studimi në universitetet italiane përbën avantazh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE

5. Të ketë dy rekomandime nga personel akademik që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit.
- Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë së është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.
7. Të paraqesë projekt propozimin individual për kërkimin shkencor.

***B. Kush mund të aplikojë në Programin e Doktoraturës pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike***

Studimet e doktoratës ofrohen me prioritet për ata persona që e kanë detyrim ligjor kualifikimin e tyre në nivelin e tretë të studimeve, për shkak të punësimit si personel akademik në IAL.

Prioritete të shpallura janë:

1. Personel akademik i punësuar me kohë të plotë në:
  - Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës.
  - Fakultetet e fushës së drejtësisë të universiteteve të tjera publike dhe jopublike.
2. Staf akademik me kohë të pjesshme i Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës kur është i punësuar me kohë të plotë në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
3. Punonjës të institucioneve dhe organizatave publike dhe jopublike, që përfshihen në kërkim bazë ose të zbatuar, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të njësive bazë të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike.
4. Punonjës të institucioneve dhe organizatave publike dhe jopublike, që përfshihen në kërkim bazë ose të zbatuar, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të njësive bazë nga Kosova, Maqedonia, trojet shqiptare dhe diaspora apo vende të tjera.

***C. Dokumentacioni për aplikim***

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë formularin e aplikimit së bashku me të gjithë dosjen e aplikimit, e cila duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën e kandidatit drejtuar Departamentit të Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike. (kliko këtu).
2. CV e kandidatit (preferohet në formatin Europass) së bashku me publikimet e tij, të cilat duhet të jenë të dokumentuara.
3. Kopje të noterizuar të diplomës/diplomave që ka në zotërim, së bashku me suplementin e notave.
4. Fotokopje të Kartës së Identitetit/Pasaportës.
5. Dy fotografi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE

6. Vetëdeklarim të aplikantit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimit doktoratë. (kliko këtu)
7. Vërtetim nga qendra e punës që kandidati ka angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, ose të organizatave publike dhe jo publike, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të shpallur në thirrje sipas pikës D
8. Dy rekomandime nga personel akademik që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor".
9. Dëshmi të mbrojtjes së gjuhës së huaj (kopje e noterizuar) sipas pikës 5, të rubrikës A.
10. Mandat-pagesën e tarifës së aplikimit për konkurim. (kliko këtu)
11. Dëshmi dhe vërtetime mbi kualifikimet e trajnimeve, artikujve shkencorë, provimeve pasuniversitare, apo pjesëmarrje në konferenca kombëtare apo ndërkombëtare, shkëmbime Erasmus +, etj.
12. Projekt propozimi individual për kërkimin shkencor. (kliko këtu)

***D. Fushat kryesore të kërkimit shkencor***

Misioni i studimeve në ciklin e tretë Doktoratë në e "Drejtë Publike" është kualifikimi, edukimi dhe përgatitja e kërkuesëve të pavarur në nivel të lartë, në përputhje me parimet e njohura shkencore e etike. Nëpërmjet studimeve të thelluara dhe të avancuara në teorinë dhe në kërkimin shkencor në fushat e së Drejtës Publike.

Fushat kryesore sipas standardeve ndërkombëtare janë:

1. E Drejtë Kushtetuese,
2. E Drejtë Penale
3. E Drejtë Publike
4. E Drejtë Administrative
5. Historia e së Drejtës
6. E Drejtë Ndërkombëtare
7. E Drejtë e BE-së